



Forcimi i Bashkëpunimit Strategjik ndërmjet BE dhe Rajonit të Ballkanit Perëndimor në fushën e Kërkimit në TIK.

Ambjenti i kërkimit të TIK në SHQIPËRI



Projekt i financuar nga Komisioni European nën prioritetin tematik "Information Society Technologies" të Programit FP6 për kërkim dhe zhvillim teknologjik.

Përmbajtja

AMBJENTI I KËRKIMIT TË TIK NË SHQIPËRI.....	1
ABSTRAKT..... FEHLER! TEXTMARKE NICHT DEFINIERT.	
1 PLATFORMA E POLITIKËS TË TIK TË SHQIPËRISË	4
1.1 ELEMENETËT E POLITIKË-BËRJES TË KËRKIMIT NË TIK.....	6
2 PËRSHKRIM I AKTIVITETEVE KËRKIMORE TË TIK.....	8
2.1 PROJEKTET KËRKIMORE TË TIK	8
2.2 KOMPETENCAT KYÇE NË FUSHAT E KËRKIMIT TË TIK	9
3 UDHËZUESIT KRYESORË TË KËRKIMIT NË TIK.....	9
3.1 TENDENCAT KRYESORE TË SEKTORIT TË TIK NË SHQIPËRI.....	9
3.2 SFIDAT KRYESORE SOCIO-EKONOMIKE NË SHQIPËRI.....	12

PERMBLEDHJE

Ky raport u zhvillua për herë të parë në mars 2007, në kuadër të projektit të financuar nga Komisioni Evropian: SCORE *“Forcimi i Bashkëpunimit Strategjik ndërmjet BE dhe Rajonit të Ballkanit Perëndimor në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”* dhe mbështeti ekspertët e TIK gjatë fazës së parë të konsultimit (Maj-Qershor 2007) në identifikimin e prioritetëve me rëndësi të kërkimit në TIK në secilin vend të Ballkanit Perëndimor për periudhën 2007-2013. Mbas fazës së parë të konsultimit, dokumenti u rishikua dhe përmirësua në Shtator 2007.

Raporti parashtron një përmbledhje të shkurtër të mjedisit të kërkimit të TIK në Shqipëri.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e konsideron zhvillimin e shoqërisë së informacionit, si dhe përdorimin dhe përhapjen e TIK në vend si një nga prioritetet më të larta për të arritur standarte të larta jetese dhe rritje ekonomike. Synimet e Strategjisë Kombëtare të TIK janë shfrytëzimi i potencialeve të TIK me qëllim për të promovuar zhvillimin njerëzor në vend, për të mbështetur rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të rritur standartet e jetesës për të gjithë popullatën.

Spektori TIK në Shqipëri ka patur një rritje të konsiderueshme këto vitet e fundit. Është i dukshëm numri i kompanive të TIK të krijuara dhe aktive këto pesë vitet e fundit. Në këto 3 vitet e fundit liberalizimi i tregut të Telekomunikacionit është ndjekur nga krijimi i një numri operatorësh telefonik.

Aktivitetet e kërkimit shkencor në Shqipëri janë shumë të kufizuara, kryesisht për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe pamjaftueshmërisë së burimeve financiare. Një numër i konsiderueshëm i specialistëve i kanë braktisur institucionet kërkimore shkencore dhe shumica e tyre kanë emigruar jashtë. Departamentet e specializuara të TIK në veçanti e kanë vuajtur në mënyrë të konsiderueshme “migrimin e trurit”.

Gjithsesi, në kontekstin e proceseve të integrimit Euro-Atlantik, komuniteti akademik është përfshirë në disa projekte të rëndësishme rajonale të financuara nga Komisioni Evropian. Pjesëmarrja e vendit në Programin e 7 Kuadër të Komisionit Evropian, si një aktivitet i rëndësishëm që inkurajon integrimin evropian, mbështetet nëpërmjet pjesëmarrjes në projektet SEE-ERA dhe IDEALIST.

Projektet kryesore në kërkimin TIK në vend, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar janë të fokusuara kryesisht në qeverisje elektronike, shëndet elektronik, të mësuarit elektronik dhe infrastrukturë elektronike. Kapacitetet kryesore të kërkimit në TIK të organizatave kërkimore në Shqipëri përfshijnë: TIK në mbështetje të biznesit dhe industrisë; TIK për të plotësuar sfidat shoqërore të qeverisjes; Programet, Teknologjitë Grid, siguria dhe besueshmëria; ICT për përmbytjen, krijueshmërinë dhe zhvillimin personal; TIK për arritjen e sfidave shoqërore në shëndetësi; etj.

Gjatë vitit 2007, Këshilli i Ministrave miratoi statusin e Shqipërisë si anëtare e asociuar e FP7. Për të antarësuar vendin në Programin FP7, qeveria miratoi një projekt për financimin e 200.000 Eurove.

TIK duhet të përdoret për të krijuar punësim, për të përmirësuar kushtet e punësimit dhe për të motivuar individët me arsim të lartë të qëndrojnë në Shqipëri. Nevojat dhe rrethanat kombëtare dhe lokale do të jenë një faktor i rëndësishëm që duhet të merret parasysh për zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit në Shqipëri.

1 PLATFORMA E POLITIKËS SË TIK TË SHQIPËRISË

1.1 Platforma e përgjithshme e politikës së TIK

Strategjia Kombëtare Shqiptare e TIK¹ u zhvillua nga një projekt i bashkëfinancuar nga Fondacioni SOROS, Departamenti i Marrëdhënieve Ekonomike dhe Sociale të Kombeve të Bashkuara, UNDP Shqipëri. Qëllimi i saj ka qenë të lehtësojë përpjekjet e Qeverisë së Shqipërisë, në bashkëpunim me aktorë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, për të krijuar një Strategji Kombëtare të TIK që identifikon mekanizmat dhe platformat ligjore dhe fiskale që nevojiten për zbatimin e qeverisjes elektronike, të mësuarit elektronik, iniciativave të tregtisë elektronike dhe zhvillimit të vazhdueshëm të infrastrukturës së TIK. Kjo Strategji është zhvilluar në kontekstin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim Social-Ekonomik, Marrëveshjen Europiane të Stabilizim Asocimit, dhe aktiviteteve rajonale të Paktit të Stabilitetit. Qeveria e Republikës së Shqipërisë është përfshirë në “eSEE - Axhendën Europiane për Zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit²”. Kjo axhendë përfshin aktivitete dhe një plan kohor për zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit, të cilat janë në një linjë me planin e veprimeve të përcaktuara në këtë Strategji Kombëtare të TIK, duke përfaqësuar kështu një pjesë të procesit rajonal.

Strategjia ngrihet mbi disa iniciativa individuale dhe sektoriale të implementuar tashmë nga organizata të tjera ndërkombëtare, sic janë aktivitetet e qeverisjes elektronike të drejtuara nga Qeveria Italiane, Banka Botërore, Bashkimi Europian, DFID dhe USAID, aktivitetet e të mësuarit elektronik dhe e-profesionet të drejtuara nga Fondacioni SOROS dhe GTZ, si dhe aktivitete të ndërthurura të fushës së TIK të financuara nga donatorë të tjerë.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e konsideron zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe përdorimin dhe shtrirjen e TIK në vend si një nga prioritetet më të rëndësishme në arritjen e standardeve më të larta të jetesës dhe të rritjes ekonomike.

Dokumenti i Strategjisë Kombëtare të TIK përshkruan objektivat e përgjithshme të Strategjisë dhe përcakton një numër veprimesh strategjike për t'i shërbyer arritjes së këtyre qëllimeve. Për këtë arsye, strategjia është ndarë në pesë seksione dhe katërmbëdhjetë qëllime individuale. Seksionet përshkruajnë zonat strategjike kryesore që do të adresohen dhe janë të orientuara drejt grupeve të ndryshme të interesit në vend:

- Seksioni I: Qeveria si Promovuese, Ligjëvënëse dhe Përdoruese e TIK, i drejtohet qeverisë dhe adreson nevojat për struktura të përshtatshme institucionale të TIK, përcaktimin e politikave dhe paraqitjen e shërbimeve të qeverisjes elektronike.
- Seksioni II: Përdorimi i TIK për Edukim, Kërkim, Shëndetësi dhe Shërbime Sociale, synon zbatimin e TIK për përfitimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve.

¹ Strategjia Kombëtare e TIK e Republikës së Shqipërisë, krijuar në 2002, nën projektin me emër “Strategjia Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit” – bashkëfinancuar nga Fondacioni SOROS, Departamenti i Marrëdhënieve Ekonomike dhe Sociale të Kombeve të Bashkuara, dhe UNDP Shqipëri., <http://www.undp.org.al/index.php?page=projects/project&id=32>, <http://www.ictd.org.al>

² “eSEE – Axhenda Evropiane për Zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit“ një veprim i përbashkët për implementimin e Shoqërisë së Informacionit në Europën Jug Lindore, krijuar në 28-29 Tetor 2002 në Beograd gjatë konferencës të Europës Jug Lindore mbi Bashkëpunimin dhe Politikën e Telekomunikacioneve. <http://www.eseeuropeconference.org/agenda.html>

- Seksioni III: Ndërtimi i Infrastrukturës së nevojshme për një Shoqëri të Hapur të Informacionit, adreson nevojën për shpërndarjen e infrastrukturës së nevojshme për shoqërinë e informacionit.
- Seksioni IV: Gjenerimi i Rritjes Ekonomike në Sektorin Privat adreson nevojën për të nxitur sektorin privat për të përqafuar mjetet e shoqërisë së informacionit.
- Seksioni V: Sigurimi i Rëndësisë së Strategjisë së TIK në një Kontekst Rajonal dhe Evropian fokusohet mbi nevojën për të siguruar bashkëpunimin në një nivel ndërkombëtar të politikave të TIK.

Çdo Seksion është i ndarë në objektiva të ndryshëm të cilët përbëjnë nivelin më të detajuar të dokumentit të strategjisë. Tabela e mëposhtme përshkruan seksionet dhe objektivat e politikave Kombëtare të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për Republikën e Shqipërisë.

Seksion i Strategjisë Kombëtare të TIK	Objektivi
I. Qeveria si Promovuese, Ligjvënëse dhe Përdoruese e TIK	1. Politika Kombëtare të TIK proaktive dhe të koordinuara mirë.
	2. Krijimi i Ambjentit Ligjor Mbështetës së TIK.
	3. Shërbime publike dhe qeverisje më efektive, më transparente dhe më e përgjegjshme: <ul style="list-style-type: none"> • Nën-qëllim 3.1: Shërbimet dhe institucionet e qeverisjes elektronike të nivelit qendror. • Nën-qëllim 3.2: Shërbimet e qeverisjes elektronike në nivel lokal dhe rajonal.
II. Përdorimi i TIK për Edukim, Kërkim, Shëndetësi dhe Shërbime Sociale	4. Promovimi i literaturës bazë kompjuterike – Edukimi i TIK për gjithkënd.
	5. Krijimi i një grupi specialistësh të avancuar të TIK – Edukim dhe Kërkim në fushën e TIK.
	6. TIK në Shëndetësi dhe Shërbime Sociale.
	7. Mbështetja e zhvillimit të përmbajtjes dhe aplikimeve përkatëse lokale.
III. Ndërtimi i Infrastrukturës së nevojshme për një Shoqëri të Hapur të Informacionit	8. Krijimi i një sektori konkurues dhe të liberalizuar të telekomunikacioneve.
	9. Zhvillimi i një infrastrukture jo të kushtueshme të shpejtë dhe të sigurtë të TIK kudo në Shqipëri.
IV. Gjenerimi i Rritjes Ekonomike në Sektorin Privat	10. Zhvillimi i sektorit të TIK si një sektor prodhues.
	11. Mbështetja e biznesit elektronik.
V. Sigurimi i Rëndësisë së Strategjisë së TIK në një Kontekst Rajonal dhe Evropian	12. Pjesëmarrje aktive në iniciativat rajonale të Evropës Juglindore.
	13. Pjesëmarrje aktive në iniciativat e BE.
	14. Monitorimi i zhvillimeve të TIK Shqiptare në kuadrin Rajonal dhe Evropian.

Gjatë vitit 2006 Qeveria shqiptare me mbështetjen e UNDP, ndërmori iniciativën për të rishikuar dhe përshtatur strategjinë e TIK. Procesi i konsultimit i mbajtur gjatë 2006 u mbyll me një projekt dokument “Draft-propozim për Strategjinë e Ndërthurur midis TIK dhe Telekomunikacionit”, i cili akoma nuk është zyrtarizuar për publikun³.

Përveç gjithë këtyre përpjekjeve, Shqipërisë akoma i mungon një strukturë e vërtetë zyrtare TIK.

Një nga masat e marra së fundmi nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë është krijimi i “Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” (AKSHI), e cila do të përgatisë një politikë strategjike, do të koordinojë dhe mbikqyrë zbatimin e programeve dhe projekteve për Shoqërinë e Informacionit. Struktura dhe Organika e saj do të miratohen nga Kryeministri.

Objektivat kryesore të Agjencisë janë:

- a) Përpilimi dhe zbatimi i politikave, strategjive, akteve ligjore zyrtare për zhvillimin e Sektorit të Shoqërisë së Informacionit.
- b) Koordinimi i politikave dhe programeve në fushën e Shoqërisë së Informacionit.
- c) Promovimi i investimeve në fushën e Shoqërisë së Informacionit.
- d) Promovimi i Teknologjive të reja në fushën e Shoqërisë së Informacionit.
- e) Edukimi dhe nxitja e përdorimit të TIK nga publiku.

Disa detyra të tjera që do të kryejë agjencia janë: 1) Zhvillimi i një rrjeti të brendshëm të TIK për administratën publike duke përfshirë një rrjet qeverisjeje (GovNet), koordinimi për kompjuterizimin e sektorëve të ndryshëm dhe institucioneve më të rëndësishme, duke krijuar shërbime online. 2) Mbështetja dhe koordinimi i projektit për dixhitalizimin e akteve ligjore, arkivave, librarive. 3) Nxitja dhe mbështetja e TIK për shkollat publike, duke përfshirë kompjuterizimin dhe aksesin në internet 4) Nxitja dhe mbështetja e zhvillimit të biznesit elektronik 5) Nxitja dhe mbështetja e përdorimit të shërbimeve online, internetit dhe kompjuterit nga qytetarët 6) Bashkëpunimi me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat në fushën e Shoqërisë së Informacionit.

1.1 Elementet e politikë-bërjes të kërkimit të TIK

Aktivitetet e kërkimit shkencor në Shqipëri janë shumë të kufizuara, së pari për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve financiare. Një numër i konsiderueshëm specialistësh kanë braktisur institutet e kërkimit shkencor dhe shumica e tyre kanë emigruar jashtë. Departamentet e specilizuara të TIK në veçanti kanë vuajtur në masë të konsiderueshme nga “migrimi i trurit” Për të njëjtën arsye, institucionet publike hasin në vështirësi të mëdha për të gjetur specialistët e nevojshëm për mirëmbajtjen e përditëshme të sistemeve të infrastrukturës së TIK. Komuniteti akademik është injoruar dhe për pasojë, nuk është përfshirë në projekte të rëndësishme të TIK. Kjo jo vetëm që i penalizon këto projekte duke mos përfshirë specialistë të pavarur nga qarqet akademike, por penalizon edhe vetë specialistët duke i shtyrë ata drejt emigrimit. Specialistët e TIK janë të demotivuar nga pagat e ulëta, që prishin gjithë sistemin e punës së kërkimit shkencor publik në Shqipëri. Kjo çon në pasoja serioze, ndonëse të fshehura, për sistemin e institucioneve të kërkimit shkencor, duke sjellë efekte afatgjata negative.⁴

³ UNDP, Shqipëri, Qershor 2007

⁴ Republika e Shqipërisë, Vlerësimi Elektronik – Raport për statusin e TIK në Shqipëri, 2002-2005

Megjithatë, në kontekstin e integritit të proceseve Euro-Atlantike, komuniteti akademik është përfshirë në disa projekte të rëndësishme rajonale të financuara nga Komisioni Evropian. Këto projekte përfaqësojnë një arritje të zhvillimit Evropian të kërkimit shkencor në Ballkan dhe në vendet rreth tij. Shembuj tipikë janë projektet SEEREN dhe SEEREN2 për lidhjen e rrjeteve të kërkimit kombëtar në arsim të vendeve të Ballkanit me rrjetin pan-evropian të kërkimit në arsim GEANT; gjithashtu projektet SEE_GRID dhe SEE_GRID2, të cilat synojnë transferimin dhe zhvillimin në rajonin e Evropës Juglindore të rezultateve të projekteve në teknologjitë GRID, si një komponent i rëndësishëm në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA). Teknologjitë GRID aftësojnë shfrytëzimin e burimeve në rrjetet pan-evropiane të kërkimit në arsim nëpërmjet pjesëmarrjes në organizata kërkimi virtuale evropiane. Projekti i financuar nga Qeveria Italiane për krijimin e Rrjetit Kombëtar Akademik (kërkim në arsim) në vend pritet që të jetë me rëndësi të veçantë.⁵

Përveç zhvillimit të teknologjive të reja dhe zbatimeve, FP7 parashikon vazhdimin e projektit shumëvjeçar GEANT që realizon lidhjen mes rrjeteve akademike kombëtare në super rrjetin pan-evropian, gjithashtu edhe me rrjete nga kontinente të tjera.

Programi aktual kombëtar për kërkimin dhe zhvillimin në TIK gjatë 2007-2009, duke u bazuar në rezultatet e arritura, drejtimet e zhvillimit aktual ndërkombëtar dhe synimet qeveritare, kërkon të inkurajojë zhvillime të reja në TIK dhe përdorimin e tyre.

Pjesëmarrja e vendit në Programin e 7 Kuadër të Komisionit Evropian, si një aktivitet që inkurajon integrimin evropian, mbështetet nëpërmjet pjesëmarrjes në projektet SEE – ERA dhe IDEALIST. SEE-ERA synon të rrisë lidhjet midis institucioneve rajonale për inkurajimin e aktiviteteve të përbashkëta; IDEALIST synon qarkullimin e informacionit në projekt-propozime të ndryshme të FP7 dhe pjesëmarrja në të inkurajohet. Objektivat kryesorë të kërkimit dhe zhvillimit kombëtar janë:

- Përmirësimi i edukimit për specialistët me njohuritë dhe zhvillimet në TIK.
- Zhvillimi i rrjeteve kompjuterike për t'i shërbyer edukimit dhe kërkimit.
- Zhvillimi i zgjidhjeve të integruara teknologjike dhe aplikimeve të ndara.
- Krijimi i databazave dhe rritja e sigurisë në rrjete.
- Njohja dhe zbatimi i teknologjive të reja për edukimin dhe kërkimin në TIK.
- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese kombëtare dhe ndërkombëtare për TIK⁶

Gjatë vitit 2007⁷, Këshilli i Ministrave miratoi statusin e Shqipërisë si e antarësuar në FP7. Për të antarësimin e vendit në Programin FP7, qeveria miratoi një projekt duke financuar nga buxheti afro 200 mijë Euro. Pjesa tjetër e fondeve do të mblidhet nga Bashkimi Evropian. Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, kjo iniciativë përbën kontributin më të madh financiar që është dhënë në këto 15 vitet e fundit në favor të kërkimit shkencor dhe është hapi kryesor në integrimin e vendit në ERA (Hapësirën Evropiane të Kërkimit). Ministri i Edukimit dhe Shkencës, Z. Pollo tha se nga ky projekt mund të përfitojnë të gjitha institucionet kërkimore shkencore, universitetet, kompanitë private, entet publike dhe agjencitë e ndryshme qëndrore, si dhe individët të cilët mund të aplikojnë duket ndërtuar konsorciume me subjekte homologe të vendeve anëtare të BE.

⁵ Ministria e Arsimit dhe Shkencës: Sistemet TIK, Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim, 2007–2009, Tiranë, 04.06.2007

⁶ Ministria e Arsimit dhe Shkencës: Sistemet e Informacionit dhe Teknologjisë, PKKZH 2007-2009, Tiranë, 04.06.2007

⁷ “Gazeta Shekulli”- “Qeveria hedh 200 mijë euro për të qënë anëtare e asociuar në FP7”, 8 Shtator 2007

2 PËRSHKRIM I AKTIVITETEVE KËRKIMORE TË TIK

2.1 Projektet kërkimore të TIK

Siç e përmendëm në kapitullin e mëparshëm, kërkimi në TIK në Shqipëri nuk ka qënë në qendër të vëmendjes. Megjithatë, ka disa projekte që përqëndrohen në kërkimin në TIK në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Tabela e mëposhtme është një përmbledhje e disa projekteve kërkimore të TIK (kombëtare dhe ndërkombëtare) të kryera gjatë pesë viteve të fundit në Shqipëri. Të dhënat janë mbledhur gjatë aktiviteteve të projektit SCORE. Disa prej projekteve veçanërisht ato të nivelit kombëtar, nuk përbëjnë aktivitete kërkimi direkt, por më shumë aktivitete zhvillimi si psh. sigurimin e infrastrukturës për të krijuar një mjedis të përshatshëm për aktivitete të ardhshme kërkimi.

Fusha e kërkimit të TIK	Projekte Kombëtare	Projekte Ndërkombëtare	Niveli i përafërt i financimit
Qeveria Elektronike	Ndërtimi i infrastrukturës LAN në Shkollën e Mesme të Policisë në Tiranë dhe përdorimi i tyre në rifreskimin e informacionit administrativ, didaktiko shkencor dhe bibliotekës bazuar në informacion.	1. SWEB 2. GOVNET 3. Mbështetje për pilotimin e shërbimeve të qeverisë elektronike të Shqipërisë	181,215 Euro (Nuk përfshihen fondet për GOVNET dhe Mbështetjen per pilotimin...)
Shëndeti Elektronik	Zhvillimi i Sistemit informativ dhe administratimi i bazave të të dhënave në sektorin e shëndetit publik.		75,585 Euro
Të Mësuarit Elektronik Shkenca Elektronike Infrastruktura Elektronike	Vendosja e rrjetit të infrastrukturës për Akademinë e Edukimit Fizik në Tiranë, përdorimi i tij në qarkullimin e informacionit didaktik dhe shkencor bazuar në teknologjitë hiper tekstuale.	1. SEEREN 2	75,618 Euro
Infrastruktura Elektronike Shkenca Elektronike	Një aplikim i kompjuterizuar për aktivitetin e sekretarisë shkollore dhe administrimi i informacionit në procesin e mësimdhënies.	1. SEE-GRID, 2. SEE-GRID2	180,220 Euro
Libraritë Dixhitale	Aplikimi i gjuhës kompjuterike; përmbledhje automatike dhe kërkimi tekstual.		23,252 Euro
Prokurimi Elektronik		ELLECTRA WEB	
Dogana Elektronike		RAC-WEB	71, 160 Euro

Formulimi i Politikave të Kërkimit të TIK		1. SCORE	100, 000 Euro
Trajnimi dhe sensibilizimi i TIK		1. SEEFIRE in 2006 2. IS2WEB, 3. SEE-Innovation	149, 650 Euro
Promovimi i mbrojtjes së mjedisit dhe manaxhimi i resurseve		ISOTEIA http://www.isoteia.org/	0
Të Mësuarit Elektronik për përmirësimin e aksesimit të Shoqërisë së Informacionit të SME-ve në Evropën Juglindore.		ELISA në vazhdimësi http://www.elisa-project.net/	0

2.2 Kompetencat kyçe në fushat e kërkimit të TIK

Bazuar në mbledhjen e të dhënave të kryera në kuadër të projekteve të FP6, IS2WEB dhe SEE INNOVATION fushat e mëposhtme paraqesin kapacitetet dhe kompetencat kryesore të kërkimit në TIK të organizatave kërkimore në Shqipëri.

Klasifikimi i fushave kërkimore të TIK	Numri i organizatave kërkimore
TIK për ndërmarrjet (proceset e biznesit, organizimi i punës)	18
TIK për Qeverinë	16
Programet, Teknologjitë Grid, siguria dhe besueshmëria	12
Ambjentet personale	10
Mediat e reja	10
TIK për mësimin, Të Mësuarit elektronik	9
Ambjentet shtëpiake	8
TIK për shëndetin	7
TIK për lëvizshmërinë	7
Sistemet Embedded, kompjuterizimi dhe kontrolli	6
Njohuritë, sistemet njohëse të të mësuarit	6
TIK për trashëgiminë kulturore	6
TIK për fabrikimin	6
TIK për përfshirje	5
TIK për Mjedisin	5
Simulimi, vizualizimi bashkëveprimi dhe realitetet mikse	4
Perspektivat e reja në dizejimin e TIK në shkenca dhe disiplina të tjera të teknologjisë	4
Infrastruktura Inteligjente	4
TIK për besueshmëri dhe confidence	4
Teknologji të të ardhmes dhe ato në krijim	4
Sistemet robotike	1


3 UDHËZUESIT KRYESORË TË KËRKIMIT TË TIK

3.1 Tendencat kryesore të sektorit të TIK në SHQIPËRI

Sektori i TIK ne Shqipëri ka pësuar rritje të konsiderueshme këto vitet e fundit. Duhet të përmendim numrin e madh të kompanive të TIK të krijuara dhe aktive këto pesë vitet e fundit. Në tre vitet e fundit, liberalizmi i tregut të Telekomunikacionit është ndjekur nga themelimi i disa Operatorëve të Telekomit. (www.ert.gov.al).

Grafiku i mëposhtëm na jep një pamje më të qartë të të ardhurave të sektorëve të TIK sipas Segmenteve⁸.

Revenue of the ICT Sectors by Segments



Shumica e produkteve importohen nga jashtë. Gjithsesi, ka një tendencë të fortë dhe në rritje në sektorin e TIK për të përshtatur produktet për nevojat lokale. Disa programe janë përshtatur në gjuhën vendase. Ka një shumëllojshmëri zgjedhjesh në lidhje me pajisjet dhe programet, në të cilat kanë akses dhe mund t'i përballojnë shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, sikundërse edhe shumë individë. Mesatarja e investimeve vjetore në TIK është rreth 2.5-3 milion dollarë (ose 2.2 milion Euro) dhe të gjitha të ardhurat nga TIK shkojnë deri në 20 milion dollarë (ose 15 milion Euro)⁹.

Duke patur parasysh arritjet që sektori shqiptar i TIK ka patur vitet e fundit, nevojat teknologjike mbeten në nivel të konsiderueshëm. Ekziston nevoja për mbulimin e gjithë territorit me Internet. Ka nevojë për infrastrukturë të rrjetit të shpejtë dhe të besueshme.

3.1.1 Hardware

Numri i kompjuterave në vend vlerësohet 85,000¹⁰, ku 40-50% e tyre përdoren nga bizneset dhe administrate publike. Numri i kompjuterave për 1000 banorë është rreth 12¹¹ nga 8 që ishte në vitin 2000.

3.1.2 Shërbimet e Telekomunikacionit

Liberalizmi i Tregut të Telekomunikacionit solli krijimin e disa arritjeve në Sektorin e TIK në Shqipëri, ku mund të përmendim krijimin e disa operatorëve të Telekomit dhe subjekte të liçensuara¹², si:

⁸ Statistika të publikuara nga Dhoma e Tregtisë së Tiranës dhe Shqipërisë, <http://www.cci.gov.al>.

⁹ Republika e Shqipërisë, Vlerësimi Elektronik – Raport mbi gjendjen e teknologjisë së informacionit dhe komunikacionit në Shqipëri, 2002-2005

¹⁰ Commerce Canada (2004-2005), commercecan.ic.gc.ca

¹¹ Banka Botërore “TIK me një shikim”, 2005

- Operatorë me licensë të Klasës së Parë (Albtelecom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a., Vodafone Albania sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.).
- Operatorë Publik të Telekomunikacionit në zonat rurale (51 operatorë).
- Subjekte të licensuara për të ofruar shërbime interneti – ISP (25 subjekte)
- Subjekte të licencuara për të ofruar shërbime të “Transmetimit të të dhënave” (6 subjekte)
- Ofrues të Shërbimeve të Telekomunikacionit (22 të tillë).

3.1.3 Voice Telephony

Numri i abonentëve të telekomit në fund të marsit 2007 ishte 259,134, prej të cilëve 240,440 janë familje¹³.

Faktori kryesor në këtë sektor është Albtelekomi, deri në mes të 2007 kompani e zotëruar nga shteti. Albtelekomi u privatizua më në fund (76% të aksioneve) në 19 Qershor 2007, nga konsorciumi turk “Calik” për 120 milion dollarë¹⁴.

3.1.4 Telefonia e lëvizshme

Shërbimet e telefonisë së lëvizshme janë një sektor që përjetoi një rritje të mahnitshme gjatë këtyre 8 viteve të fundit. Dy operatorë kryesorë sundojnë tregun. I pari është Albanian Mobile Communication (AMC), një kompani shtetërore që u shit në 1999 një partneriteti të përbashkët mes COSMOTE (Greqi) dhe TELENOR (Norvegji). Licensa e dytë u dha në vitin 2001 nga një konsorcium i Vodafone (UK) dhe Panafon (Greqi). Një licensë e tretë u dha në mars të 2004 për Albtelekom.

Në 1996, vetëm 2,300 abonentë kishin shërbimin e telefonisë së lëvizshme. Në fund të vitit 2004, dy operatorët e telefonisë së lëvizshme kishin më shumë se 1.5 milion klientë së bashku¹⁵. Një raport i bakës Botërore (TIK me një shikim) në 2005 tregon 405 abonentë (për 1000 vetë) nga një bazë prej 10 abonentësh në vitin 2000.

AMC dhe Vodafone sundojnë tregun. Aktualisht, rreth 80%¹⁶ e territorit shqiptar është e mbuluar me shërbime GSM. Kjo i korrespondon 90% të gjithë popullsisë. Gjithsesi, tarifat e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri janë ende të larta në krahasim me nivelet evropiane. Investime të tjera në këtë fushë do të ulin tarifat dhe do të përmirësojnë cilësinë e shërbimit.

Në mars të viti 2004, Enti Rregullator i Telekomunikacionit, siguroi Licensën Individuale të Klasës së Parë për Eagle Mobile sh.a. për të ofruar shërbim telefonie të lëvizshme, tokësor, GSM standart në Republikën e Shqipërisë. Eagle Mobile është operatori i tretë i telefonisë celulare në Shqipëri, që do të hyjë së shpejti në treg duke ofruar tarifa konkurruese dhe një zonë të gjerë mbulimi. Albtelecom sh.a. zotëronte 100% të aksioneve. Kompania e re, si një operator telefonie celulare, ishte pjesë e paketës në shitje të Albtelecom sh.a.

¹² Enti Rregullator i Telekomunikacionit, www.ert.gov.al/ert_eng/static_down/Lista%20e%20ISP_Anglisht.pdf

¹³ INSTAT – Buletin Statistikor Tremujor, nr.1, 2007

¹⁴ Ministri Ruli firmos kontratën e shitjes të Albtelecom, Qershor 2007, <http://www.eaglemobile.al/content/view/9/1>

¹⁵ Bugs, Bytes and Glitches – Skuadra e Teknologjisë së Informacionit dhe Telekomunikacionit, Departamenti Amerikan i Tregtisë, Tregjet e Telekomunikacionit të Evropës Lindore, Verë 2006
http://www.emich.edu/ict_usa/Telecom/E%20Europe%20Telecom%20-%20A-K%20-%20Summer06.pdf

¹⁶ Bugs, Bytes and Glitches - Skuadra e Teknologjisë së Informacionit dhe Telekomunikacionit, Departamenti Amerikan i Tregtisë, Tregjet e Telekomunikacionit të Evropës Lindore, Verë 2006
http://www.emich.edu/ict_usa/Telecom/E%20Europe%20Telecom%20-%20A-K%20-%20Summer06.pdf

3.1.5 Telekomunikacioni rural

Tregu për telekomunikacionin rural u liberalizua në vitin 2000. Që atëhere, Enti Rregullator i Telekomunikacionit (ERT) ka miratuar afërsisht 51¹⁷ liçensa të operatorëve ruralë.

Plan i Qeverisë për telekomunin rural është kryesisht i bazuar në një përjasje të sektorit privat. Numri i banorëve që jetojnë në zona rurale është afërsisht 1.7 milion, ndërkohë që numri i banorëve të zonave rurale që kanë aktualisht linjë telefoni në shtëpitë e tyre është rreth 25,000¹⁸. Operatorëve privatë ruralë i mungon kapitali i nevojshëm, teknologjia dhe ndërlidhja për të plotësuar me shërbime këtë segment të tregut.

3.1.6 Internet Service Providers (ISPs)

Ligji që vepron për aktivitetin e ISP-ve hyri në fuqi në 1997 dhe liçensa e parë u lëshua po atë vit. Aktualisht, ka 25 ISP të liçensuara¹⁹.

Numri i përdoruesëve të internetit deri tani është vlerësuar rreth 75,000 (2005 est.) dhe numri i hostuesëve të Internetit është 430 (2006 est.).²⁰

3.2 Sfidat kryesore socio-ekonomike në SHQIPËRI

Vlerësimi i fundit i (CCA)²¹ i ndërmarrë nga Kombet e Bashkuara në Shqipëri ka identifikuar 4 faktorë të ndërlidhur që influencojnë vënien në jetë të strategjive zhvilluese kombëtare. Ato janë: (i) decentralizimi i institucioneve të ngarkuara me sigurimin e shërbimeve bazë sociale dhe me shtimin e pjesmarrjes lokale në formulimin e strategjive të zhvillimit; (ii) reforma institucionale me qëllim shtimin e efikasitetit, të transparencës dhe përfshirjes së institucioneve shtetërore; (iii) aksesit i grupeve të interesit për informacion, procesin e vendimmarrjes si dhe shpërndarjen e aseteve; (iv) cilësia e analizave të projektuara për monitorimin dhe drejtimin e zhvillimit.

Treguesit makroekonomikë tregojnë një shkallë rritje pozitive për Shqipërinë në vitet e fundit. Megjithatë performanca ka qenë mbresëlënëse, ka probleme duke marrë parasysh qëndrueshmërinë e ritmit të lartë të rritjes ekonomike. Në veçanti qeveria shqiptare duhet të vërejë me vëmendje ndryshimet e rëndësishme në shpërndarjen e GDP sipas aktivitetit ekonomik. Qeveria duhet të caktojë një pjesë më të madhe të investimeve në infrastrukturë veçanërisht në sektorin e arsimit, shëndetit dhe mjedisit. Përmirësimet në këto fusha do të shërbejnë në shtimin e cilësisë të kapitalit njerëzor, duke përmirësuar jetëgjatësinë, kushtet e jetesës dhe nivelin e aftësive.

Vëmendje e veçantë po i kushtohet varfërisë së tejskajshme ekonomike që ekziston në veri dhe veri-lindje të vendit. Qeveria shqiptare duhet ti përkushtojë vëmendje të veçantë përmirësimit të infrastrukturës publike si të nevojshme për të rritur cilësinë e përgjithshme të jetesës së popullsisë. Analizat e të dhënave kryesore dhe ndërlidhjet e tyre të brendshme

¹⁷ www.ert.gov.al

¹⁸ Bugs, Bytes and Glitches - Skuadra e Teknologjisë së Informacionit dhe Telekomunikacionit, Departamenti Amerikan i Tregtisë, Tregjet e Telekomunikacionit të Evropës Lindore, Verë 2006
http://www.emich.edu/ict_usa/Telecom/E%20Europe%20Telecom%20-%20A-K%20-%20Summer06.pdf

¹⁹ www.ert.gov.al

²⁰ Studim Ndërkombëtar i Tregut – Libri i Fakteve Botërore - Shqipëri, 2007, www.strategis.ic.gc.ca/epic/site/imr-ri.nsf/en/gr-05003e.html

²¹ Vlerësimi i zakonshëm i Vendit, UN Shqipëri 2004

tregojnë që investimi më i madh kërkohet në infrastrukturën e transportit, energjisë, ujit e kanalizimeve. Duke shtuar mundësinë e ndërhyrjes në këto zona do të ndihmohet zvogëlimi i dallimeve gjeografike në ofrimin e shërbimeve kryesore. Menaxhimi i pamjaftueshëm mjedisor është shpesh shenjë e mosfunksionit të insitucioneve publike, që çon në pengimin e suksesit të strategjive të zhvillimit. Më shumë përpjekje nevojiten për të krijuar struktura institucionale efektive për ndërveprim midis punonjësve civilë dhe publikë. Zyrtarët publikë duhet të marrin një trajnim më të mirë për të siguruar një kontroll më efektiv të rregullave dhe ligjeve.

CCA sugjeron që aksesimi në shërbimet bazë, vazhdimi i reformave kryesore social-ekonomike, decentralizimi, përmirësimi i kapacitetit lëvruar publik dhe të dhënat e disponueshme duhet të adresohen në mënyrë adekuate vendit për të patur progres të dukshëm drejt rezultatit. Thelbi i sfidave të qeverisjes përfshin vëzhgimin e zbatimit të ligjit dhe ruajtjen e stabilitetit dhe besueshmërisë politike.

CCA 2004 ka identifikuar një seri sfidash dhe mundësish zhvillimi. Këto përfshijnë uljen e varfërisë, rritjen e respektimit të të drejtave të njeriut, fushatat kombëtare të arsimit drejtuar diskriminimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut, iniciativat që nxisin pjesëmarrjen e të rinjve në strategjinë e zhvillimit, nxitjen e të dy përfaqësive lokale dhe globale në zhvillimin ekonomik, përmirësimin e mbledhjes së të dhënave në lidhje me pabarazitë sociale dhe ekonomike dhe promovimin e analizave rajonale në MDG (Qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit). Hapat e mëtejshëm shihen në termat e përmirësimit të marrdhënieve të sektorit publik-privat, forcimin e lehtësirave të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përfshirjen e aktorëve kryesorë në vendimmarrje.

Një nga sfidat kryesore që përballet Shqipëria është rritja e *emigrimit të trurit*,²² e cila udhëhiqet nga aspiratat për një cilësi më të mirë jetese. “Emigrimi i trurit” ose rrjedhja e kapitalit njerëzor më të kualifikuar mund të imponojë një kosto të rëndësishme ekonomike dhe sociale mbi një vend duke zvogëluar mundësinë e qeverisë për të lëvruar shërbimet bazë dhe duke influencuar aftësitë të tyre për të arritur Qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe reformat e tjera kritike. Sipas një vëzhgimi të kohëve të fundit të drejtuar nga Qendra e Studimeve Social-Ekonomike, gjatë periudhës 1991-2005, më shumë se 50 % e lektorëve dhe studiuesve nga Universitetet Institucionet shqiptare dhe emigruan. Kryesisht më shumë se 70% e tyre kanë emigruar me familjet. Besohet se shumë prej këtyre intelektualëve shqiptarë jashtë shtetit nuk punojnë në profesionet e tyre, prandaj ky fenomen përfshin një humbje të potencialit intelektual ose emigrimin e trurit.

Me qëllim që të transformojë rrjedhjen e trurit në thithjen e trurit, qeveria shqiptare ka filluar iniciativën e thithjes së trurit. Hapat kryesore në këtë proces janë për të kontrolluar kush po emigron dhe pse, për të kuptuar impaktet kryesisht ekonomike dhe sociale të emigracionit dhe për të identifikuar kushtet e brendshme dhe politikave të nevojshme për të nxitur individët e kualifikuar (trurin) për të qendruar ose për tu kthyer në Shqipëri. Në veçanti të dy faktorët shtytës dhe tërheqës të “emigrimit të trurit” kanë nevojë të identifikohen me kujdes dhe të adresohen nëpërmjet politikave të përshtatshme.

Programi i Thithjes së Trurit të UNDP synon të mbështesë krijimin e stimulimeve të nevojshme dhe mekanizmave të politikave kombëtare për të angazhuar Diasporën shqiptare në zhvillimin shkencor, administrativ dhe ekonomik të vendit. Programi do të shikojë gjithashtu edhe dërgimin e fondeve si pjesë e një raporti bilanci që ka nevojë të kuptohet më mirë në mënyrë që të vlerësojë impaktin që ka migrimi në zhvillim.

²² UNDP Shqipëri: “Nga migrimi i Trurit të Thithjes së Turit: Mobilizimi i Diasporës së talentuar shqiptare – Një Policy paper për Shqipërinë, Prill 2006

Lidhur mesa më sipër, qëllimet e Strategjisë Kombëtare të TIK janë të nxjerrë në pah mundësitë e TIK në mënyrë që të promovojë zhvillimin e burime njerëzore të vendit, për të mbështetur zhvillime të qendrueshme dhe ekonomike dhe të rrisë standardet e jetesës për tërësinë e popullësisë. TIK duhet të përdoret për të krijuar mundësi punësimi, për të përmirësuar kushtet e punës dhe për të motivuar individët e mirë arsimuar të qendrojnë në vend. Nevojat dhe rrethanat kombëtare do të jenë një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit në Shqipëri.